

Deklarate Per Shtyp E Urdherit Te Mjekeve Te Shqiperis Mbi Ndodhine Ne Maternitetin “Koco Glozheni” Tirane

U.M.SH. ka ndjekur me vemendje rastin e rende te ndodhur ne kete maternitet. Para se gjithash ne shprehim dhimbjen e thelle dhe ngushellimet familjareve per kete humbje.

U.M.S.H nuk merr persiper te jap para kohe perfundimet mbi rastin ne fjale, te shkaktuar nga nje patologji e rende e ralle dhe e veshtire. Ne pritje te konkluzioneve te sakta dhe shkencore, per te cilat po punohet dhe ne jemi seriozisht te interesuar per to, e shohim te domosdoshem te shprehim qendrimin tone, ashtu sic kemi vepruar edhe here te tjera ne te tilla raste.

Ne jemi kategorikisht kunder qendrimeve dhe masave te parakohshme, emocionale dhe ekstreme qe cojne ne arrestimin e mjekeve pa u provuar dhe argumentuar fajsia e tyre, pa u sqaruar nese kemi te bejme me mjekim te pakujdesshem (neglizhence), gabim mjeksor apo mangesi te organizimit dhe bashkerendimit institucional dhe nderinstitucional qe nevojitet ne te tilla raste. Masat ekstreme dhe te nxituara nuk kane asnje efekt dobiprures ne permiresimin e sherbimit shendetsor por perkundrazi thellojne krizen e besimit te publikut ndaj bluzave te bardha dhe sistemit shendetsor ne teresi. U.M.SH. eshte i angazhuar ne ndjekjen dhe analizimin profesional dhe shkencor, hap pas hapi te kesaj ngjarjeje dhe nxjerrjen e konkluzioneve te sakta ne drejtimet e theksuara me siper.